

KADASTRA FISKALE

BULETIN INFORMUES

Botimi 5

28 PRILL 2022

Testim i pagesës së parë përmes Sistemit IT të Kadastrës Fiskale!

Realizimi i pagesës së faturës të taksës së pasurisë përmes Sistemit të përmirësuar të Kadastrës Fiskale është bërë në fillim të muajit Prill.

Sistemi IT i Kadastrës Fiskale është tashmë gati të trajtojë procedurat e plota të taksës së pasurisë që nga regjistrimi i pronës deri te menaxhimi i detyrimeve të taksapaguesve.

Ecuria e zhvillimeve

Kur DPTP dhe ekipi i ProTax Albania vizituan Selenicën në muajin Mars morën shumë informacion nga nëpunësit që punonin me taksën e ndërtesës. Ata ndanë problemet me të cilat ndeshen gjatë punës së tyre. Një nga problemet është mungesa e të dhënave të digjitalizuara e cila kërkon inspektime në terren, gjë që është mjaft e vështirë për ta. Një tjetër problem është gjithashtu dhe mungesa e materialeve informuese për taksapaguesit.

Bazuar në informacionet që u morën gjatë vizitës, DPTP dhe ProTax zhvilluan një proces të ri për inspektimet në terren. Me ndihmën e tabletëve, inspektorët në terren do kenë mundësi të regjistrojnë të dhënat e ndërtesave drejtpërdrejt në sistemin e IT.



Në Bashkinë Selenicë si një nga bashkitë pilot, është testuar pagesa e faturës përmes Postës Shqiptare. Ky proces është realizuar i plotë.

Versioni i përditësuar i sistemit IT, përveç faturës së taksës së ndërtesës ofron mundësinë të aplikohen dhe taksa të tjera vendore në të. Kjo do të thotë që një taksapagues tashmë do të paguajë vetëm një komision në momentin e kryerjes së pagesës.

Rruga drejt një taksimi të qëndrueshëm dhe të drejtë në Shqipëri

Në fillim të muajit Prill, midis përfaqësuesve nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, DPTP dhe projekti ProTax u organizuan 2 (dy) workshope. Në këto workshope u diskutua gjerësisht mbi draft-ligjin dhe si parashikimet e tij mund të ndihmojnë që të arrihet një taksë pasurie e drejtë, transparente dhe kosto-efikase. Në këtë aspekt, në nivel strategjik janë përcaktuar dhe miratuar bazat për ligjin e ri.

Ekspertët nga projekti ProTax prezantuan strategjitë, qasjet dhe eksperiencat më të mira ndërkombëtare sesi mund të shkohet drejt një sistemi të drejtë, transparent dhe kosto-efikas të taksës së pasurisë duke ndihmuar në fuqizimin e bashkive dhe uljen e barrës administrative nëpërmjet:

- Njohja e rregullave që lehtësojnë procesin e punës.
- Aplikimi i një procesi pune të unifikuar për të gjitha bashkitë. Kjo gjë jo vetëm që do të ulë kostot administrative, por do të mundësojë ndarjen e eksperiencave të punës me të gjithë. Gjithashtu do të mundësojë qëndrueshmërinë e disa pjesëve të administrimit.
- Ky proces nga ana tjetër do të reduktojë kostot, do të lehtësojë barrën administrative dhe do të ofrojë nëpunësve të bashkisë kushtet e nevojshme për të rritur përpjekjet e tyre në regjistrim dhe mbledhjen e detyrimeve.

Në përfundim të aktivitetit, grupi i punës së krijuar finalizoi draftin për ligjin e ri të taksës së pasurisë. Pas miratimit nga ministria, do të jetë subjekt i konsultimeve me palët e tjera të interesuara.

Rritja e interesit për të punuar në Sistemin IT të Kadastrës Fiskale

Interesi nga ana e bashkive për të punuar në Sistemin IT të Kadastrës Fiskale po rritet vazhdimisht. Nisur nga ky interes i lartë, me kërkesë të bashkisë Elbasan, DPTP dhe ekspertët e projektit ProTax zhvilluan një vizitë në këtë bashki.

Fillimisht pati një takim me nënkryetaren e Bashkisë Znj. Aulona Bylykbashi dhe me Drejtorin e Përgjithshëm të Planifikimit të të Ardhurave, Aseteve, Buxhetit dhe Financës dhe Drejtorin e Taksave Vendore.

Në vijim u organizua një workshop ku u prezantua sistemi i përditësuar i IT-së dhe të gjitha funksionalitetet e nevojshme për taksimin e pasurisë së paluajtshme. Përmirësimi dhe shtimi i funksionaliteteve të reja do të lehtësojë punën në sistem.

Nëpunësit e bashkisë, të cilët ndoqën prezantimin nga ana e ekspertëve, e vlerësuan sistemin si mjaft të thjeshtë në përdorim dhe efikas.

Në vazhdim, gjatë muajit Maj, ekspertët e projektit ProTax dhe DPTP, jo vetëm në bashkinë Elbasan, të cilët kanë shprehur interes, por do të vizitojnë dhe bashki të tjera të angazhuara për të punuar në Sistemin IT të Kadastrës Fiskale.



Reforma e Taksës së Pasurisë kryhet pjesërisht përmes bashkëpunimit midis Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe Agjencisë Suedeze të Taksave. Bashkëpunimi zhvillohet përmes projektit të quajtur ProTax Albania.

Qëllimi i projektit është **fuqizimi i bashkive duke rritur të ardhurat e tyre vetjake**. Projekti synon administrim modern dhe uniform të taksës së ndërtesës, ku taksimi do të bazohet në vlerën e tregut. Një sistem i qendëruar IT, cilësi e përmirësuar e regjistrave dhe taksapagues të mirë informuar, së bashku me një kuadër ligjor modern pritet ta bëjnë taksimin më të drejtë dhe efikas.

ProTax Albania financohet nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Zhvillim.



**Ministria e Financave dhe
Ekonomisë**
**Bulevardi Dëshmorët e Kombit
Nr.3, Tiranë**



Alvaro.Bulku@financa.gov.al
Klaudia.Vukzaj@financa.gov.al
Valmira.Fejza@financa.gov.al



<https://dptp.financa.gov.al>